



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 18413 Prot

Lezhë, më 23.10.2025

NJOFTIM

Për thirrjen e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Lezhë

Drejtuar: Anëtarëve të Këshillit Bashkiak Lezhë

Për dijeni: Kryetarit të Bashkisë Lezhë

Për dijeni: Prefektit të Qarkut Lezhë

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore”, neni 53 pika 2, pika 4, neni 56, pika 2 shkronja “a” dhe në Rregulloren e Këshillit të Bashkisë Lezhë, e miratuar me VKB nr. 54, datë 28.04.2020, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Lezhë me shkresën nr.prot. 358/1, datë 15.05.2020, i ndryshuar, njoftoj thirrjen e **mbledhjes së radhës (Tetor 2025)** të Këshillit Bashkiak Lezhë, ditën e **enjte**, në datën **30.10.2025**, në orën **11:00**, në sallën e Këshillit Bashkiak (në Pallatin e Kulturës Lezhë), me këtë

REND DITE:

1. Projekt-Vendim “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-30 Shtator 2025”
2. Projekt-Vendim “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë, të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2025”
3. Projekt-Vendim “Për një shtesë në Vendimin nr. 74, datë 25.09.2024 “Për miratimin e pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë, të punonjësve administrativë, të punonjësve mbështetës dhe të masës së shpërblimit mujor të këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave” i ndryshuar”
4. Projekt-Vendim “Për miratimin e hapjes së rrugës “ByPass-i i Shëngjinit”, Njësia Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë, në fondin pyjor bashkiak”
5. Projekt-Vendim “Për dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqes pyjore në pronësi të bashkisë, për kryerjen e aktivitetit minerar në objektin Gjjobardhaj, nga shoqëria “Gjoni” shpk”
6. Projekt-Vendim “Për miratimin e krijimit të një “kafeterie leximi” si dhe dhënies me qira të ambientit me vendndodhje në pjesën anësore në katin e parë të bibliotekës publike “Gjergj Fishta” me sip. 115.6 m² pjesë e pasurisë nr. 9/32, ZK 8631, pronë e Bashkisë Lezhë, për një afat 1 (një) vit”
7. Projekt-Vendim “Për miratimin e marrëveshjes së subvencionimit ndërmjet programit URBACT IV 2021-2027 dhe Bashkisë Lezhë për projektin “URBACT PIONEERS ACCELERATOR”
8. Projekt-Vendim “Për emërtimin e rrugës me nr. 57 03170051 me emrin “Gjergj Kovaçi” në fshatin Tresh, Njësia Administrative Zejmen”
9. Projekt-Vendim “Për emërtimin e rrugës me nr. 46 03170040 me emrin “Jak Kovaçi” në fshatin Tresh, Njësia Administrative Zejmen”

10. Projekt-Vendim "Për emërtimin e rrugës me nr. 60 03170055 me emrin "Pjetër Jak Zefaj" në fshatin Tresh, Njësia Administrative Zejmen"
11. Informacion mbi realizimin e Buxhetit për 9-mujorin e vitit 2025
12. Të ndryshme

Grafiku i mbledhjeve të komisioneve:

Nr	Komisioni	Dita	Data	Ora
1	Komisioni i Urbanistikës, Programeve të Zhvillimit dhe Integritetit	E mërkurë	29.10.2025	08:30
2	Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqenies Sociale dhe Strehimit	E mërkurë	29.10.2025	09:00
3	Komisioni i Bujqësisë	E mërkurë	29.10.2025	09:30
4	Komisioni i Mandateve, Rregulloreve dhe Çështjeve Juridike	E mërkurë	29.10.2025	10:00
5	Komisioni i Financës, Buxhetit dhe Zhvillimit Strategjik	E mërkurë	29.10.2025	10:00

**KRYETARI
NDUE LULI**

